



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



ZHVILLIMI I NJË KONCEPT NOTE

Andreja Tonč, Ekspert për grante i
TACSO (Asistencë teknike për
organizata të shoqërisë civile)

MAJ 2020



Delivering Sustainable Solutions



LDK
CONSULTANTS

QËLLIMI I UEBINARIT

- Për t'i mbështetur OShC-ët e interesuara në procesin e aplikimit dhe zhvillimit të Koncept Notës për Thirrjen në kuadër të **Programit IPA për Përkrahje të Shoqërisë Civile dhe Media 2018 - 2019 për Kosovë - Qendra e burimeve të shoqërisë civile - faza II dhe Mbështetje për projekte inovative në fushën e mbrojtjes sociale**. Referencë e publikimit: EuropeAid/168894/DD/ACT/XK
- Ofrimi i informacionit dhe shkëmbimi i përvojës mbi zhvillimin e Koncept Notës për OShC-ët e tjera dhe publikun e interesuar.



PROGRAMI I UEBINARIT

- **Hyrje**
- **Vendi i Koncept Notës në procedurën e aplikimit për grante të BE-së**
 - Informata bazë për Thirrjen
 - Si të aplikohet në fazën e KN-së
 - Risi në qasje: teoria e ndryshimit, fokusimi në rezultate dhe arritje (outcomes)
 - Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut dhe integrimi gjinor
- **Si të zhvillohet një Koncept Notë efektive**
 - Roli dhe struktura e formatit të KN-së
 - Pyetjet kryesore për t'u përgjigjur/informatat për t'u ofruar
 - Dështimet kryesore në ofrimin e informatave në lidhje me formatin e KN-së dhe kriteret e vlerësimit
- **Pyetje dhe përgjigje**



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



Vendi i Koncept Notës në procedurën e aplikimit për grante të BE-së



Delivering Sustainable Solutions



LDK
CONSULTANTS

INFORMATA BAZË PËR THIRRJEN

- **Thirrja** është publikuar në linkun e mëposhtëm:
<https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome>
- Afati i fundit për dorëzimin e Koncept Notave (KN-ve) është **8 qershor 2020** (faza e parë e procesit të aplikimit).
- Shuma e përgjithshme në dispozicion është **1.4 milion EUR** (3 projekte)
- Kohëzgjatja e projekteve: **36 – 42 muaj**
- **Aplikantët e pranueshëm:** OSHC-ët e regjistruara në Kosovë për të paktën 2 vjet dhe me historik në sektorin e synuar të aplikimit.
- **Dy objektiva=dy lloje:**
 - **Llot 1** Qendra e burimeve të shoqërisë civile - faza II
 - **Llot 2** – Mbështetje ndaj projekteve inovative në fushën e mbrojtjes sociale



LLOT 1: QENDRA E BURIMEVE TË SHOQËRISË CIVILE - FAZA II

- Vazhdimi i **rolit të QB-së** të mëparshëm.
- **Ndërtimi i kapaciteteve** të OSHC-ve bazuar në nevojat e identifikuara.
- Përmirësimi i **bashkëpunimit** midis OShC-ve dhe me institucione dhe aktorë të tjerë relevant.
- Promovimi i **iniciativave vullnetare** përmes mekanizmit të granteve (100,000 EUR për grante me vlerë maksimum prej 5,000 EUR për grant).
- Mbështetje dhe bashkëpunim i ngushtë me **TACSO**.
- **500,000EUR** në dispozicion.





LLOT 2: PROJEKTE INOVATIVE NË MBROJTJEN SOCIALE



- Ofrim i mbështetjes për **grupet më të cenueshme**.
- **Shërbime mbështetëse dhe ndihmëse të natyrave të ndryshme** (p.sh. mjekësore, psikologjike, edukative, të mbrojtjes dhe rehabilitimit, etj.).
- Koordinim me **Qendrat për Punë Sociale** dhe shërbime të tjera relevante në **komunat e synuara**.
- **Aspektet inovative!**
- **Universitetet publike** janë të pranueshme si bashkë-aplikantë për një pjesë të punës shkencore (kërkime, inovacion).
- **900,000EUR** në dispozicion.



SI TË APLIKOHET NË FAZËN E KN: PADOR DHE PROSPECT

PADOR	PROSPECT
Ofrim i informacioneve në lidhje me organizatat e përfshira në veprim.	Ofrimi i informacioneve në lidhje me veprimin në dokumentet e listuara në seksionet 2.2.2 (koncept nota) dhe 2.2.5 (aplikacioni i plotë).
Regjistrimi i këtyre të dhënave në PADOR është i obligueshëm: <ul style="list-style-type: none"> • Hapi i Koncept Notës: aplikantët kryesorë • Hapi i aplikacionit të plotë: bashkë-aplikant(ët) dhe subjektet e lidhura. 	Dorëzimi përmes internetit i Koncept Notës dhe i aplikacionit të plotë përmes PROSPECT-it është i obligueshëm.
Aplikantët kryesorë duhet të sigurohen që profili i tyre PADOR është i përditësuar. Mos prisni deri në momentin e fundit për përditësim të të dhënave!	Mos prisni deri në momentin e fundit për dorëzimin përmes internetit!
Më shumë informata në: http://ec.europa.eu/europeaid/pador_en dhe shërbimi i ndihmës i TI-së në: EuropeAid-IT-support@ec.europa.eu	Më shumë informata në: https://ec.europa.eu/europeaid/user-manual-prospect_en dhe shërbimi i ndihmës i TI-së në EuropeAid-IT-support@ec.europa.eu



PROCESI I KONCEPT NOTËS

PROCESI I APLIKIMIT

- ✓ Formulari i obligueshëm në anglisht: Shtojca A1. Formulari i aplikimit për grante
- ✓ Nuk ka shtojca shtesë që duhet të dërgohen.
- ✓ Përfshin vetëm një përlllogaritje të shumës së kontributit të kërkuar të BE-së, si dhe të një përqindjeje treguese të atij kontributi në lidhje me kostot e pranueshme të veprimit.
- ✓ Elementet e paraqitura tek koncept nota nuk mund të modifikohen në aplikacionin e plotë.
- ✓ Afati i fundit: 8 qershor 2020 në orën 12:00 CET

PROCESI I VLERËSIMIT

- **Kontrollet e hapjes dhe administrative:**
 - Respektimi i afatit të fundit, formularit, gjuhës, të gjitha pyetjeve të përgjigjura, pranueshmërisë së veprimit, shumës së kërkuar, etj.
 - Lista e kontrollit në Seksionin 2 e Pjesës A të formularit të aplikimit për grant.
- **Vlerësimi i KN-së**
 - Relevanca dhe dizajni i veprimit
 - Tabela e vlerësimit për Koncept Notën është në dispozicion në UpA (Udhëzimet për aplikantë).
 - Maksimumi 50 pikë për një KN dhe minimumi 30 pikë të nevojshme për t'u kualifikuar për para-përzgjedhje.
 - Lista e rezultateve më të mira të shënuara bazuar në shumën totale të kontributeve të kërkuara, e cila është e barabartë me 200% e buxhetit në dispozicion për këtë Thirrje/Llot.
 - Aplikantët kryesorë të para-përzgjedhur do të ftohen



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



Risi në qasje: Teoria e ndryshimit





RISI NË QASJE - TEORIA E NDRYSHIMIT



KORNIZA LOGJIKE që nga viti 1992




KORNIZA LOGJIKE K. TEORISË SË NDRYSHIMIT

- Mjet** për planifikim dhe monitorim të projekteve
- Përqendruar në projekt (logjikë) të ndërhyrjes (**zmadhim në një rrugë specifike**)
- Përqendrim në **hapa logjikë dhe detaje të ndërhyrjes**
- Linear**
- Paraqitur në një **diagram** (matricë, kornizë logjike)
- Mjet** për planifikim dhe monitorim të projekteve
- Përfsh. **fotografi të madhe/kontekst dhe rrugë të ndryshme**
- Përqendrim në **ndryshim**
- Qarkore/përfsh. **afate për komentim**
- Paraqitur në një **diagram** (trekëndësh, kuti, kornizë logjike, etj.)




Theory of Change

Shows the big picture with all possible pathways – messy and complex



Logical Framework

Shows just the pathway that your program deals with – neat and tidy



KORNIZA LOGJIKE E PËRDITËSUAR E BE


- Qasja QKL (Qasja e kornizës logjike) u zhvendos drejt përqendrimit në ndryshim
→ **përfsh. Teorinë e ndryshimit**
- Reflektuar në terminologjinë dhe kuptimin e Kornizës Logjike:
 - Logjika e ndërhyrjes → Zinxhiri i rezultateve
 - Objektivat e përgjithshme → Ndikimi
 - Objektivat specifike → Arritjet (outcomes)
 - Prodhimet (outputs) → Rezultatet
 - Aktivitetet → Aktivitetet

KORNIZA LOGJIKE E PËRDITËSUAR E BE

- **Treguesit** janë përditësuar me 3 kolona shitesë për t'i shtjelluar treguesit në një kornizë monitorimi që do të përdoret gjatë zbatimit të projektit:
 - **Baza fillestare** (vlera konkrete e treguesve në fillimin e matjes, gjithashtu mund të jetë vlerë aktuale);
 - **Vlera aktuale** (vlera konkrete e treguesve në fillimin e zbatimit të projektit);
 - **Synimi** (vlera konkrete e treguesve që duhet të arrihet në fund të projektit dhe gjithashtu një nivel i prodhimit, arritjes, ndikimit të pritur).

ZINXHIRI I REZULTATEVE (i përdorur në Kornizën Logjike të BE-së)

Një diagram i thjeshtë për të treguar se si një projekt do të nxisë nivele të ndryshme të ndryshimit nga aktivitetet në ndikim.





SHEMBULL I ZINXHIRIT TË REZULTATEVE (i përdorur në Kornizën Logjike të BE-së)





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



Qasja e Bazuar në të Drejta (QBD) dhe integrimi gjinor



Delivering Sustainable Solutions



LDK
CONSULTANTS



Qasja e Bazuar në të Drejta


- Aplikon parimet dhe standardet e të drejtave të njeriut si mjet dhe si qëllim i bashkëpunimit për zhvillim.
- Ndryshon qasjen analitike dhe integron arritjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave dhe programeve zhvillimore.
- Pako e QBD-së gjendet në:
https://ec.europa.eu/international-partnerships/topics/human-rights_en



Objektivat e QBD-së:

Mos u dëmtoni - projektet nuk duhet të shkaktojnë dëm të papranueshëm dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Bëjeni më të mirën - duke krijuar ndikim pozitiv për sa i përket të drejtave të njeriut siç është forcimi i kapaciteteve për të zbatuar strategji zhvillimore, fuqizimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut, nxitja e pjesëmarrjes, mbështetja e institucioneve shtetërore në cilësinë e tyre si mbikëqyrës dhe rregullator, forcimi i llogaridhënies dhe i mekanizmave të kontrollit dhe trajtimi i korrupsionit.





PARIMET UDHËZUESE TË PUNËS E QBD



1. *Legaliteti, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut*
2. *Pjesëmarrja dhe qasja në procesin e vendimmarrjes*
3. *Mosdiskriminimi dhe qasja e barabartë*
4. *Llogaridhënia dhe qasja në sundimin e ligjit*
5. *Transparenca dhe qasja në informacion*



ELEMENTET E NDËRLIDHURA E PROPOZIMEVE

- Propozimet duhet të përfshijnë sa herë që të jetë e rëndësishme **barazinë gjinore, çështjet mjedisore, nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e pakicave ose inovacionin dhe praktikat më të mira.**
- Për më tepër, inkurajohet një qasje e përbashkët e OShC-ve dhe një **partneritet i fortë me aktorë lokalë**, duke përfshirë një lidhje me të drejtat e njeriut dhe institucionet gjyqësore në nivel kombëtar, si dhe organizatat ndërkombëtare.
- Këta **elementë me vlerë të shtuar** duhet të pasqyrohen si në Koncept Notë edhe në aplikacionin e plotë.





INTEGRIMI GJINOR

- **Barazia gjinore** është një pjesë integrale e QBD-së, që përfshin promovimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të gjitha të drejtave të njeriut.
- Secili propozim i përzgjedhur do të duhet të raportojë kundrejt treguesve përkatës "SMART" të ndarë sipas gjinisë të përmendur në **Planin e Veprimit për Çështje Gjinore e BE-së 2016-2020** që është i detyrueshëm.
- https://ec.europa.eu/anti-trafficking/eu-policy/joint-staff-working-document-gender-equality-and-womens-empowerment-transforming-lives_en

Transforming the lives of GIRLS and WOMEN through EU External Relations 2016-20

EU OBJECTIVES:



Girls and women live free from all forms of violence and discrimination.



Girls and women participate as equals in the economic life and have access to all economic resources and social services.



Girls and women participate equally in decision-making at all levels.



Commission services and EEAS deliver more effectively on EU commitments towards gender equality and women's empowerment through external relations.

our world
our dignity
our future

2015
European Year
for Development



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



Si të zhvillohet një Koncept Notë efektive





KONCEPT NOTA

*"Sa më pak
tekst por me
rëndësi të
madhe!"*





STORJA E KONCEPT NOTËS

- Gjatë zhvillimit të KN-së duhet t'ia parashtrojmë vetvetes në radhë të parë **dy pyetje kryesore:**
 - Cili është ndryshimi që duam ta shohim si rezultat i punës sonë?
 - Pse?



KËRKESA TEKNIKE

- ✓ Ndiqni nga afër shabllonin.
- ✓ Duhet të jetë në **anglisht**.
- ✓ Mos i tejkaloni **5 faqet e plota (madhësia A4) të karaktereve Arial 10 me margjina 2 cm, largësinë e vetme mes rreshtave (Line spacing: Single)**.
- ✓ Nënshkrimi i **Deklaratës nga aplikanti** për Koncept Notën (pjesë e shabllonit të KN-së).





ELEMENTET E KONCEPT NOTËS

1.1.
Përmbledhje e
veprimit

1.2. Përshkrimi
i veprimit

1.3. Relevanca
e veprimit

1.4. Aplikanti
kryesor

1.5. Detajet e
projektit

1.1. Përmbledhje e veprimit

- Tabela pa një limit madhësie.
- Kërkohet ofrimi i informacionit kryesor për:
 - **Objektivat** e përgjithshme (d.m.th. Ndikimi) dhe specifike (d.m.th. Arritja(et) e veprimit
 - **Grupi i synuar** - përfitimi i drejtpërdrejtë nga veprimi
 - **Përfituesit përfundimtarë** - përfitim afatgjatë
 - **Prodhimet** e përlogaritura
 - **Aktivitetet** kryesore
- Plotësoni këtë pjesë pasi të keni përfunduar me përcaktimin e relevancës dhe dizajnit të veprimit.
- Jini të qartë, konciz dhe konsistent me pjesën tjetër të dokumentit.

1.2. Përshkrimi i veprimit – maksimalisht 2 faqe

- I. **Historiku** i përgatitjes së veprimit (studime, analiza, sfida)
- II. **Objektivat** - shpjegoni ato të paraqitura në 1.1. Përmbledhje
- III. **Aktorë kryesorë** - përfshirja në përgatitjen dhe zbatimin
- IV. **Aktivitetet** - llojet, grupet, grumbullimet, lidhjet midis tyre
- V. **Integrimi i çështjeve të ndërlidhura** - rikujtim për udhëzimet nga UpA. Gjithashtu kontrolloni listën e dokumenteve nga udhëzimet e KN-së (fq. 9).

1.2. Përshkrimi i veprimit – maksimalisht 2 faqe

- Sfida kryesore në këtë pjesë është paraqitja e **idesë së përgjithshme** dhe mënyra se si planifikohet të zbatohet. **(maksimalisht 10 pikë gjatë vlerësimit)**
- Sidoqoftë, ju duhet të jepni edhe informacione mbi **historikun dhe përgatitjen**. **(maksimalisht 10 pikë gjatë vlerësimit)**
- **Shmangni përsëritjen** e informacionit që është paraqitur tashmë, d.m.th. objektivat. Ofroni informacion të shkurtër për rëndësinë e tyre, vizionin tuaj për ndryshimin e dëshiruar, etj.
- **Mos radhisni vetëm aktivitete**. Ofroni informacion mbi rëndësinë e tyre dhe marrëdhëniet/lidhjet. Gruponi ato për të kursyer hapësirë. **(maksimalisht 5 pikë gjatë vlerësimit)**
- **Jini specifik me prezantimin e çështjeve të ndërlidhura**. Mos supozoni se misioni juaj i OSHC-së së veçantë është i mjaftueshëm vetëm për të konfirmuar se do t'i konsideroni ato. **Përshkruani veprime specifike që do të ndërmerrni**. **(maksimalisht 5 pikë gjatë vlerësimit)**

1.3. Relevanca e veprimit (maksimalisht 3 faqe)

1.3.1. Relevanca e objektivave/sectorëve/tematikave/prioriteteve specifike të Thirrjes

- Fjala kyçe në udhëzime është **PËRSHKRUANI!**
- Mos kopjoni/vendosni (copy/paste) objektiva dhe prioritete. Ofroni justifikim, përshkrim të rëndësisë dhe një lidhje.
- Përshkruani se si po kontribuoni në objektivat dhe prioritetet, në vend që vetëm të konfirmoni se jeni në përputhje me prioritetet e Thirrjes.
- Mos supozoni, por mendoni se si t'ia ofroni perspektivën e idesë suaj personit i cili nuk është pjesë e ekipit tuaj.
- Një deri në dy paragrafë të tekstit duhet të jenë të mjaftueshëm.
- **Maksimalisht 5 pikë gjatë vlerësimit.**

1.3. Relevanca e veprimit (maksimalisht 3 faqe)

1.3.2. Relevanca e nevojave dhe kufizimeve të veçanta të vendit(eve), rajonit(eve) dhe/ose sektorëve përkatës të synuar (duke përfshirë sinergjinë me iniciativa të tjera zhvillimore dhe shmangien e dyfishimeve)

- Në këtë pjesë ju keni mundësinë t'i paraqisni njohuritë tuaja për çështjet që planifikoni t'i adresoni!
- Përgjigjuni në të gjitha pikat nga udhëzimet.
- Mos radhisni vetëm dokumente ose të dhëna pa justifikim se si është e rëndësishme kjo për idenë tuaj të projektit.
- Shënoni pikat kryesore në tekst pasi kjo pjesë do të marrë pjesën më të madhe të hapësirës në seksionin Relevanca (mesatarisht deri në 1.5 faqe).
- Sinergjia me iniciativat e tjera zakonisht nuk shkruhet dhe për këtë arsye reflekton drejtpërdrejt në rezultatin e përgjithshëm më të ulët në këtë seksion.
- **Maksimalisht 5 pikë gjatë vlerësimit.**

1.3. Relevanca e veprimit (maksimalisht 3 faqe)

1.3.3. Përshkruani dhe përcaktoni grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë, nevojat dhe kufizimet e tyre dhe tregoni se si veprimi do t'i adresojë këto nevoja

- **Kujt, pse dhe si** janë pyetjet kryesore për të cilat duhet të keni përgjigje të qarta në mënyrë që të ofroni informacion me cilësi të mirë në këtë pjesë.
- **Projektet e mbrojtjes sociale duhet të jenë shumë precize në përkufizimin e grupeve të tyre të synuara** në mënyrë që t'i arrijnë ato dhe të dëshmojnë nevoja specifike, pozitën, cenueshmërinë, etj.
- **Bilanci në sasi!** Mos premtoni numra të konsiderueshëm që nuk mund t'i arrini më vonë.
- Paraqisni një lidhje të **grupit të synuar - nevojave të tyre - dhe përgjigjen/mbështetjen e projektit** përfshirë **procesin pjesëmarrës të GS dhe PP** (d.m.th. ky është parim i QBD-së).
- Mos harroni t'i paraqisni përfituesit përfundimtarë.
- Jini kreativ në shfrytëzimin e hapësirës, d.m.th. përdorni prezantimin e tabelave, etj.
- **Maksimalisht 5 pikë gjatë vlerësimit.**

1.3. Relevanca e veprimit (maksimalisht 3 faqe)

1.3.4. Elementë të veçantë të vlerës së shtuar

- Tregoni ndonjë element specifik të vlerës së shtuar të veprimit, p.sh. promovimi ose konsolidimi i partneriteteve publiko-private, inovacioni dhe praktika më e mirë.
- Kjo është një pjesë e rëndësishme shumë shpesh e lënë pas dore dhe përgjigjet paraqiten në vetëm dy fjali.
- Konsultoni pjesën 1.2. nga UpA.
- Risi, partneritet, QBD janë shpesh pika nga UpA.
- **Maksimalisht 5 pikë gjatë vlerësimit.**

1.4. Aplikanti kryesor (bashkë-aplikantët dhe subjektet e lidhura, nëse ka)

- Duhet të paraqisni informacionin bazë dhe detajet e kontaktit.
- Vijoni pyetjet.
- Nuk ka limit në madhësi.

1.5. Detajet e projektit

- Informacioni bazë (nuk ka limit në madhësi) për projektin përfshirë:
 - Titullin e veprimit
 - Numrin e Llotit
 - Lokacionin i veprimit
 - Kohëzgjatjen totale të veprimit (muaj)
 - Kontributin e kërkuar (shuma) e BE-së
 - Kontributin e kërkuar e BE-së si përqindje e totalit të kostove të pranueshme të veprimit



NSE NUK
PYESNI, SI DO
TA DINI?